



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 632/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Alie Tmava, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicë, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa parashtruara nga Alie Tmava, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicë, me shenjën ZL.Anr.632/2017 e datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.11.2017 në orën 18:20 minuta, nga Alie Tmava, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Mitrovicë, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicë, me të cilën pretendon se zyrtarët e Qendrës së Numërimit të votave në mënyrë sipërfaqësore dhe të manipuluar dhe absolutisht të pa numëruara sipas procedurës ligjore me këtë rast kanë ndikuar rezultatin përfundimtar sipas së cilave nuk ka arritur të bëhet anëtare e Kuvendit Komunal në Mitrovicë. Më tej ka theksuar se në dy vendvotime është dëmtuar me mbi 60 vota në Vendvotimin 1111/02R dhe Vendvotimi nr. 1104B. Ka kërkuar që të rinumërohen votat në ato Vendvotime.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore si provë ka bashkangjitur një Formular për llogaritjen e votave (Fllikë)

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesja e ankesës në ankesën e parashtruar nuk e ka dëshmuar me asnjë provë krahasueshmërinë e votave për të cilat pretendon se i mungojnë, për të vërtetuar pretendimet në ankesën e parashtruar, në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, ku është përcaktuar: “*se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”. Paneli gjatë vendosjes për një ankesë i shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në ankesë dhe kur vlerëson se pretendimet ankimore nuk janë të provuara me prova nga parashtruesi i ankesës, siç është në rastin konkret, ku parashtruesi i ankesës nuk e ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me pretendimet e tij, e refuzon ankesën si të pabazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.632/2017 më datën 10.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*